

PRANUAR 08/06/2026			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/04	21424	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 30.04.2026

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 2

Takim i rregullt / Redovni sastanak Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 13

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju
Përfaqësues të KFOR—it dhe i MPB-së, Divizioni për Këshillat Lokal*

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da

Jo / Ne

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB -së të mbajtur me datë 05.02.2026;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni Policor në Drenas;
3. Dukuritë negative, gjendja në shkolla në Drenas;
4. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Mbledhja e dytë është mbajtur me datë 03.04.2026, Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), dhe anëtarë nga ekzekutivi. Mbledhja u udhëhoq nga nënkryetari i komunës, z. Arben Shala, i cili nisi mbledhjen me miratimin e rendit të ditës me këto pika:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Në pikën e parë të rendit të ditës u shqyrtua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së, të mbajtur më 05.02.2026. Pas shqyrtimit nga anëtarët e pranishëm, procesverbali u miratua pa vërejtje.

2. Raportimi për gjendjen e sigurisë në Komunën e Drenasit

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, raportoi Komandanti i Stacionit Policor në Drenas, z. Driton Morina, i cili paraqiti një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së sigurisë në territorin e komunës. Gjatë raportimit u theksua se gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit vazhdon të jetë në përgjithësi e mirë, falë angazhimit të vazhdueshëm të Policisë së Kosovës dhe bashkëpunimit të mirë me institucionet komunale dhe qytetarët. Komandanti Morina informoi të pranishmit për aktivitetet operative të realizuara gjatë periudhës raportuese, masat e ndërmarra për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, si dhe për trajtimin e rasteve të ndryshme që lidhen me sigurinë publike, sigurinë në trafik dhe parandalimin e veprave penale. Një rëndësi e veçantë iu kushtua hapjes dhe funksionalizimit të Stacionit Policor në Komoran. Sipas raportimit, ky zhvillim ka ndikuar pozitivisht në rritjen e pranisë policore në terren, në reagimin më të shpejtë ndaj kërkesave të qytetarëve dhe në përmirësimin e përgjithshëm të shërbimeve policore për banorët e zonës së Komoranit dhe lokaliteteve përreth.

3. Raportimi për dukuritë negative dhe gjendjen në shkollat e Komunës së Drenasit

Në pikën e tretë nga DKA raportoi, znj. Laura Vrellaku. Gjatë prezantimit u paraqit gjendja aktuale në institucionet arsimore, çështjet që lidhen me sigurinë në ambientet shkollore, disiplinën e nxënësve, bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe prindërve, si dhe aktivitetet parandaluese që po zhvillohen në bashkëpunim me institucionet relevante. Gjithashtu u diskutua për rëndësinë e ngritjes së vetëdijes tek nxënësit lidhur me dukuritë negative që mund të ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, si dhe për nevojën e vazhdimin të aktiviteteve edukative dhe parandaluese në shkolla, sidomos të çështjes së bullizmit. Ajo theksoi se në vazhdimësi psikologu bashkë me stacionin policor në Drenas mbajnë ligjerata vetëdijësuese. Sipas saj, fokusi mbetet te shkollat e mesme pasi aty është me e shfaqur kjo dukuri. Arben Nika te kjo pikë ngriti shqetësimin e mungësës së orëve të kujdestarisë, të cilat sipas tij, do të ndikonin më mirë në trajtimin e kësaj çështje. Ndërsa, Anita Istogu nga QPDG me profesion psikologe, theksoi nevojën e trajnimit të stafit për trajtimin e kësaj dukurie të pranishme në shkolla.

4. Të ndryshme

Në kuadër të pikës "Të ndryshme", anëtarët e Këshillit diskutuan për çështje të ndryshme me interes për komunitetin dhe sigurinë publike në Komunën e Drenasit.

Diskutimet u fokusuan në rëndësinë e koordinimit ndërinstytucional, identifikimin në kohë të sfidave që prekin qytetarët, si dhe në nevojën për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale, Policisë së Kosovës, institucioneve arsimore dhe mekanizmave të tjerë relevant.

U diskutua gjithashtu për policet e lagjes të cilët po ndikojnë në gjendjen më të mirë në komunitet pasi i bëjnë ata më të afërt me qytetarët.

**Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)**

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Ramiz Lladrovc

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:



Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 08.06.2026

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net

- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net*

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.